Incidenti/ Policia arreston dy personat qe tentuan te godisnin gjyqtarin ne Kukes

nga AlbaniaSoccer
E shtunë, 07 Dhjetor 2013 22:09

Incidentet ne fundin e ndeshjes Kukesi-Skenderbeu nuk kane kaluar pa pasoja. Policia ka arrestuar dy punonjes te bashkise se qytetit per ndjekje penale. Edmond Elezi dhe Ermal Elezi kane tentuar te godasin gjyqtarin Enea Jorgji dhe tani duhen te perballen me drejtesine. Gjithcka nisi ne fund te ndeshjes kur gjyqtari e mbylli ndeshjen para kohe dhe kjo provokoi tension dhe acarim tek tifozet vendas te cilet zbriten ne fushe per te goditur Jorgjion. Gjithashtu ne tunelet e brendshme por dhe jashte ka patur probleme dhe tension. Nje punetor i stadiumit ka goditur trajnerin e Skenderbeut Mirel Josa gje e cila ka provokuar revolte tek miqte nga Korca.